



Çështjet lidhur me përcaktimin e tarifave të rregulluara

nga

prof. Vidmantas Jankauskas

Prezantuar gjatë trajnimit të NARUC/ERRA mbi Rregullimin e Energjisë dhe Krijimin e Tarifave

5-8 nëntor 2007, Prishtinë, UNMIK/Kosovo

Çështjet

- ▶ vlera e asetëve
- ▶ kostoja e kapitalit
- ▶ amortizimi
- ▶ lënda djegëse
- ▶ përcaktimi i kostos

Rregullatori duhet të rishqyrtojë bazën rregullative të asetëve

- ▶ për të bërë vlerësim të pavarur të asetëve
- ▶ vlera aktuale kalkulohet duke u bazuar në kostot nga e kaluara të cilat korrigjohen duke shfrytëzuar faktorët e indeksimit
- ▶ nëse çmimi i paguar nga investuesit gjatë privatizimit tejkalon vlerën e duhur të asetëve, në konsideratë duhet marrë vetëm vlerën e duhur

Asetet e shfrytëzuara dhe asetet e dobishme

- ▶ rregullatori rishqyrton strukturën e asetëve
- ▶ asetet që nuk ndërlidhen me aktivitetet rregullative do duhej të përjashtohen nga baza e tarifës
- ▶ pajisjet të cilat nga rregullatori vlerësohen se nuk janë të domosdoshme për të siguruar shërbimin e caktuar, përjashtohen nga baza e tarifës
- ▶ e njëjta gjë ndodh edhe me ndërtime që janë duke u zhvilluar

Problemet e vlerësimit të aseteve: shembulli i parë

- ▶ Në Lituanë ekzistojnë 2 kompani të distribuimit të rrymës: Perëndimorja dhe Lindorja
- ▶ Perëndimorja u Privatizua
- ▶ të dyja kompanitë rivlerësuan asetet e tyre duke e shfrytëzuar qasjen e zëvendësimit të vlerave – vlera e aseteve u rrit për 3.5 herë
- ▶ të dyja kompanitë dëshironin të rrisin shpenzimet e tyre të amortizimit si dhe të kenë fitime më të mëdha nga asetet

Vlerësimi i asetëve: shembulli i parë (vazhdim)

- ▶ NCC (rregullatori) miraton normat e amortizimit, në pajtim me legjislacionin e vendit
- ▶ NCC shqyrtoi normat e amortizimit dhe lejoi pothuajse dyfishimin e shpenzimeve të amortizimit
- ▶ kompanitë e distribuimit kanë nevojë urgjente për investime – trashëgimi nga kompania paraprakisht e integruar
- ▶ RAB për kalkulimin e fitimit është rishqyrtuar nga NCC duke shfrytëzuar kostot e indeksuara nga e kaluara

Vlerësimi i asetëve: shembulli i dytë

- ▶ Kompania Lituanëze e gasit u privatizua
- ▶ ajo rivlerësoi asetet – vlera u rrit përfaqësisht trefish
- ▶ NCC shfrytëzoi kostot e indeksuara nga e kaluara për të kalkuluar fitimin
- ▶ NCC shqyrtoi nevojat e të ardhurave nga amortizimi duke i krahasuar ato me programin investues të kompanisë (të miratuar nga rregullatori)
- ▶ Kompania Lituanëze e gazit ka paditur rregullatorin në gjykata administrative

Norma e fitimit

- ▶ teoria ekonomike thotë se profiti është fuqia kryesore që vë në lëvizje të gjitha bizneset
- ▶ në tregjet konkurruese, profiti varet nga efikasiteti i kompanisë
- ▶ rregullimi është zëvendësim (i keq) për konkurrencën
- ▶ kësisoj, në tregjet e rregulluara rregullatori duhet t'i caktojë kompanisë nën rregullim një normë të arsyeshme të fitimit

Norma e drejtë e fitimit

- ▶ norma e fitimit është profiti i kompanisë (në përqindje) që rregullatori ia lejon
- ▶ norma 'e drejtë' e fitimit definohet si e tillë që të joshë investime por që të mos sigurojë fitime joadekuate
- ▶ zakonisht ajo përcaktohet duke krahasuar fitimet në tregjet konkurruese, rreziqet e ndryshme, etj.

Vlera e amortizimit (zhvlerësimit)

- ▶ gjatë përcaktimit të vlerës së zhvlerësimit, kompania mund të shfrytëzojë lloje të ndryshme:
 - ◆ metodash (vija e drejtë dhe e përshpejtuar)
 - ◆ procedurash (grupi i gjerë, grupi tipik, grupi i jetëzgjatjes së njëjtë, amortizimi i njësive)
 - ◆ teknikash (i jetëzgjatjes së tërësishme, jetëzgjatjes së mbetur)
- ▶ rregullatori mund të përcaktojë norma të ndryshme zhvlerësimi për qëllime të përcaktimit të çmimit
- ▶ standardizimi i shfrytëzuar nga rregullatori

Lënda djegëse

- ▶ Në shumë raste kostot e lëndës djegëse tejkalohen
- ▶ Pasi që nuk kontrollohen nga kompania (çmimet e gasit, derivateve)
- ▶ Kjo funksionon mirë me rregullimet stimuluese të çmimeve – ndryshimet në çmimin e lëndëve djegëse reflektohen në formulë
- ▶ Nëse ekziston çmimi i tregut, rregullatori duhet të analizojë nëse çmimi i blerjes ka qenë konkurrues
- ▶ Nëse në treg ka ekzistuar lëndë djegëse me çmim më të ulët, rregullatori mund të mos e pranojë vendosjen e çmimit më të shtrenjtë në tarifë


Përcaktimi i kostos

- ▶ Shpërndarja e barabartë e përgjegjësisë së kostos
- ▶ Ekzistojnë disa metoda për të realizuar këtë
- ▶ Përcaktimi i kostos është më shumë art se sa shkencë dhe si i tillë gjithmonë kontestohet
- ▶ Për shembull, në shfrytëzimin e metodës së pikut koincidental konsumatorët ndahen në grupe, sipas kontributit që kanë në sistemin e ngarkesës së pikut
- ▶ Një përcaktim më i shpeshtë i konsumatorëve bazohet në nivelin e tyre të konsumit
- ▶ Ndarja e konsumatorëve në rezidencialë, komercialë dhe industrialë, etj.

Ndryshimet e pranueshme dhe të papranueshme të çmimit

- ▶ Çmimet rezidenciale janë më të ulëta se sa ato komerciale – ndër-subvencionimi i papranueshëm
- ▶ Konsumatorët ruralë i shkaktajnë kosto më të lartë shërbimit publik, por çmimet mbesin të njëjta (problemi social – i pranueshëm) apo edhe zbriten (ndër-subvencionimi – i papranueshëm)
- ▶ Në shumicën e vendeve për transmision shfrytëzohet tarifa e pullave postare (konsumatorët shfrytëzojnë të njëjtin çmim pa marrë parasysh sa larg janë gjeneratorët)

Rritja e shpejtë dhe rebalancimi i tarifave në Rumani



V.Jankauskas

Ju falemnderit!

V.Jankauskas